

EE

MA NDRYSHE

**ENERGJIA E
RINOVUESHME DHE
EFIKASITETI
ENERGJETIK NË
PRIZREN**

MARS
2025



ENERGJIA E RINOVUESHME DHE EFIKASITETI ENERGJETIK NË PRIZREN

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren,

Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7, Prishtinë

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org

029 222 771 / 038 224 967

PËRMBAJTJA

1 Hyrje

2 Situata energjetike në Kosovë krahasuar me vendet e tjera

3 Rezultatet e hulumtimit

4 Përfundime dhe rekomandime

5 Për EC-in

HYRJE

Energjia e rinovueshme dhe efikasiteti energjetik janë dy shtylla kyçe për të adresuar sfidat globale të mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Rritja e përdorimit të energjisë së pastër dhe përmirësimi i mënyrave të konsumit energjetik janë thelbësore jo vetëm për uljen e ndotjes dhe luftimin e ndryshimeve klimatike, por edhe për të siguruar stabilitet ekonomik dhe energji të përbalueshme për të gjithë. Kosova aktualisht përballet me një sfidë të madhe, duke qenë se mbështetet në mënyrë të konsiderueshme në linjit për prodhimin e energjisë elektrike, një burim me ndikim të lartë mjedisor dhe ndotës.

Ky sistem jo vetëm që ndikon negativisht në cilësinë e ajrit dhe shëndetin publik, por gjithashtu rrit kostot afatgjate të energjisë për shkak të teknologjive të vjetruara dhe mungesës së diversifikimit të burimeve energjetike. Megjithatë, situata ofron një mundësi të madhe për zhvillimin e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe përmirësimin e efijencës energjetike në sektorët publik dhe privat.

Për të kuptuar më mirë qëndrimet dhe njohuritë e qytetarëve lidhur me energjinë e rinovueshme dhe efikasitetin energjetik, në këtë hulumtim është përfshirë edhe një anketim me qytetarët e Prizrenit. Me anë të këtij hulumtimi EC është përqendruar në analizën e njohurive të qytetarëve për burimet e energjisë së rinovueshme, përdorimin e tyre dhe mundësitë për përmirësimin e efikasitetit të formave ekzistuese të energjisë.

Kosova ka potencial të konsiderueshëm për të zhvilluar energjinë e rinovueshme, veçanërisht përmes energjisë diellore dhe asaj të erës. Për shembull, në disa zona të Kosovës, numri i ditëve me diell tejkalon mesataren evropiane, duke e bërë këtë burim një opsion të qëndrueshëm dhe të përballueshëm për investime. Po ashtu, rajonet me erë të qëndrueshme, si zona e Bajgorës dhe Istogut, janë identifikuar si të përshtatshme për ndërtimin e parqeve me turbina të erës.

Në anën tjetër, përmirësimi i efikasitetit energjetik mund të ketë ndikim të menjëhershëm në reduktimin e konsumit të energjisë dhe të kostove për qytetarët dhe bizneset. Kjo mund të arrihet përmes masave si:

- Renovimi i ndërtesave publike për të reduktuar humbjet termike;
- Përdorimi i teknologjive moderne të ndriçimit dhe ngrohjes në sektorin privat dhe publik;
- Edukimi dhe vetëdijësimi i qytetarëve për të përdorur energjinë në mënyrë më të qëndrueshme.

Duke ndjekur shembullin e vendeve të BE-së, të cilat kanë arritur rezultate të jashtëzakonshme në uljen e emetimeve dhe kursimin e energjisë, Kosova mund të përfitojë nga harmonizimi i politikave të saj me direktivat evropiane.

Ligji për Energjinë dhe ai për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë krijojnë kornizën e nevojshme për promovimin e investimeve dhe zbatimin e programeve që ndihmojnë në përmirësimin e situatës aktuale.

Sidoqoftë, arritja e objektivave në këto dy fusha kërkon një angazhim të fuqishëm nga qeveria, sektori privat dhe qytetarët. Zbatimi efektiv i politikave ekzistuese, krijimi i stimujve për investitorët, dhe një kuptim më i thellë i përfitimeve të energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit energjetik do të jenë thelbësore për suksesin e këtyre përpjekjeve.

Burimet e rinovueshme të energjisë

- Biomasa është një burim energjie që përfshin mbeturina organike si ato ushqimore, bujqësore, pyjore, kopshtarie dhe industriale. Energjia prodhohet duke e djegur drejtpërdrejt për nxehtësi, duke e shndërruar në elektricitet përmes proceseve teknologjike ose duke e përpunuar në biokarburante.
- Energjia e erës shfrytëzon lëvizjen e erës për të prodhuar elektricitet duke përdorur turbina të posaçme. Tehet e turbinave rrotullojnë një gjenerator, i cili prodhon energji që dërgohet në rrjetin elektrik për përdorim. [1]

[1] Renewable Energy Sources, Sustainability and Environmental Protection: A Review”, Nura Garba and Bashir Abdulrahman, EJTAG, link: https://www.researchgate.net/publication/379594288_Renewable_Energy_Sources_Sustainability_and_Environmental_Protection_A_Review

- Energjia diellore është një burim i fuqishëm që shfrytëzon dritën e diellit për ngrohje, ftohje, ndriçim dhe prodhim elektrikiteti. Panelet fotovoltaike dhe arkitektura pasive përdoren për të kthyer rrezet e diellit në energji të dobishme për ndërtesat dhe qytetet.[2]

Masat e Qeverisë së Kosovës për subvencionimin e energjisë së rinovueshme dhe rritjen e efijencës energjetike

Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Ekonomisë, ka ndërmarrë masa për të mbështetur zhvillimin e energjisë së rinovueshme dhe për të rritur efijencën energjetike. Kjo përfshin subvencionimin e projekteve për energjinë solare dhe burimet e tjera të rinovueshme, duke ofruar fonde për qytetarët dhe bizneset që dëshirojnë të investojnë në teknologji të pastra, për të zvogëluar kostot fillestare të instalimit.

Përveç kësaj, janë ndërmarrë iniciativa për modernizimin e infrastrukturës energjetike ekzistuese dhe promovimin e teknologjive që kursejnë energji. Këto masa synojnë jo vetëm të reduktojnë ndikimin mjedisor, por edhe të rrisin sigurinë energjetike të Kosovës, duke e bërë energjinë më të qëndrueshme dhe më pak të varur nga burimet fosile.

[2] Renewable Energy Sources, Sustainability and Environmental Protection: A Review”, Nura Garba and Bashir Abdulrahman, EJTA, link: https://www.researchgate.net/publication/379594288_Renewable_Energy_Sources_Sustainability_and_Environmental_Protection_A_Review

Subvencionet kanë qenë të fokusuara kryesisht në:

- **Sisteme fotovoltaike për vetë-konsum:** është hapur një thirrje për subvencionimin e instalimit të paneleve fotovoltaike për familjet dhe ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM). Kjo masë është pjesë e Strategjisë së Energjisë dhe mbështetet edhe nga një pako energjetike prej 75 milionë euro nga Bashkimi Evropian. Subvencionet synojnë të nxisin përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe të reduktojnë varësinë nga burimet tradicionale.
- **Pajisje efikase për ngrohje dhe kursim energjie:** janë ndarë 6 milionë euro për subvencionimin e pajisjeve si kaldaja me biomasë, pompat termike, kondicionerët eficientë dhe stufat me biomasë. Kjo masë synon të reduktojë deri në 70% konsumin e energjisë për ngrohje në familje.
- **Projekte të energjisë së ripërtëritshme dhe efijencës:** në kuadër të projektit strategjik për energjinë, janë realizuar investime të ndryshme në komunat e Kosovës, duke përfshirë instalimin e paneleve diellore dhe përmirësimin e infrastrukturës energjetike.[3]

[3]Projekti i Kosovës për Efijencë të Energjisë dhe Energji të Ripërtëritshme, link:
<https://me.rks-gov.net/projekti-i-kosoves-per-eficience-te-energjise-dhe-energji-te-ripereritshme/>

Ndërlidhja e ligjit për energjinë me energjinë e rinovueshme dhe eficiencën energjetike në Kosovë

Ligji për Energjinë në Kosovë ofron kornizën ligjore dhe institucionale për të adresuar sfidat dhe mundësitë në sektorin energjetik, me fokus të veçantë në promovimin e energjisë së rinovueshme dhe përmirësimin e eficiencës energjetike. Kjo qasje është thelbësore për përmbushjen e objektivave mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Energji e rinovueshme

Ligji përfshin dispozita që promovojnë zhvillimin e burimeve të rinovueshme të energjisë (BRE), si energjia diellore, era dhe hidrocentralet e vogla. Kjo përputhet me synimet kombëtare për të arritur 35% të konsumit të përgjithshëm të energjisë nga burimet e rinovueshme deri në vitin 2031, duke kontribuar në diversifikimin e burimeve të energjisë dhe uljen e varësisë nga qymyri.

Dispozitat kryesore të ligjit krijojnë lehtësi për:

- Investimet në teknologjitë e pastra.
- Ankandet për projekte të energjisë së rinovueshme, të organizuara nga institucionet përkatëse.
- Përfshirjen e qytetarëve përmes skemave të prodhues-konsumatorëve (prosumers), ku konsumatorët mund të prodhojnë dhe furnizojnë energji në rrjet.

Efiçienca energjetike

Ligji gjithashtu vendos rregulla për përmirësimin e efikasitetit energjetik, duke synuar reduktimin e konsumit të panevojshëm të energjisë. Masa të tilla përfshijnë:

- Përcaktimin e standarteve për ndërtesat dhe pajisjet.
- Zbatimin e projekteve të renovimit për ndërtesa publike dhe private për të reduktuar humbjet energjetike.
- Promovimin e programeve të vetëdijesimit për konsumatorët dhe industrinë për të përdorur energjinë më racionalisht.

Roli i zyrës së rregullatorit për energji (ZRRrE)

ZRRrE luan një rol qendror në implementimin e këtyre politikave përmes:

- Përcaktimit të tarifave që inkurajojnë përdorimin e burimeve të rinovueshme.
- Monitorimit të performancës së operatorëve të energjisë në përputhje me objektivat ligjore dhe strategjitë kombëtare.
- Mbështetjes së zhvillimit të tregut të hapur dhe konkurrues për energjinë e pastër.

Ky ligj është i lidhur ngushtë me përpjekjet e Kosovës për t'u harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian dhe për të kontribuar në dekarbonizimin afatgjatë. Për më tepër, ai krijon një bazë për rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe reduktimin e ndotjes së ajrit – ky si një problem i madh në vend.

Ligji për Energjinë paraqet një hap të rëndësishëm drejt një sistemi energjetik të qëndrueshëm në Kosovë. Ai nuk është vetëm një instrument ligjor, por një katalizator për ndryshim, duke integruar teknologji inovative dhe praktika të qëndrueshme që janë thelbësore për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe përballimin e ndryshimeve klimatike.

[4]

SITUATA ENERGETIKE NË KOSOVË KRAHASUAR ME VENDET E TJERA

Pjesa e energjisë së rinovueshme në konsumin total të energjisë

Burimet e rinovueshme po bëhen një burim gjithnjë e më i rëndësishëm i energjisë, ndërsa vendet përpiqen të zvogëlojnë emetimet e tyre të CO₂ dhe varësinë nga lëndët djegëse fosile të importuara. Energjia e rinovueshme përdoret kryesisht për prodhimin e energjisë elektrike, megjithëse teknologjitë e rinovueshme mund të përdoren gjithashtu për ngrohje në shtëpi dhe ndërtesa.

Biokarburantet e rinovueshme janë gjithashtu një zgjidhje teknologjike në zhvillim për të reduktuar karbonin në disa pjesë të sektorit të transportit.

Është e rëndësishme të theksohet se burimet moderne të rinovueshme nuk përfshijnë përdorimet tradicionale të biomasës, si djegia e drurit të mbledhur, nënprodukteve bujqësore ose plehut organik për gatim ose ngrohje. Këto praktika kanë pasoja serioze negative për shëndetin dhe mjedisin, duke kontribuar në miliona vdekje vjetore nga ndotja e ajrit, dhe janë synuar për eliminim nga objektivat ndërkombëtare të zhvillimit dhe klimës, si dhe nga skenari Net Zero i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë (IEA).

Pjesa e konsumit të energjisë nga burimet e rinovueshme moderne (SDG 7.2), renditja globale, 2021

Renditja	Shteti/Rajoni	%
-	Bota	12.47
33	Kamboxhia	24.36
34	Kili	24.17
35	Kosova	23.99
36	Kanada	23.84
37	Rumani	23.58

Burimi: Sustainable Development Goal 7

Në renditjen globale të pjesës së burimeve moderne të rinovueshme në konsumin përfundimtar të energjisë (SDG 7.2) për vitin 2021, Kosova kishte zënë vendin e 35-të me një përqindje prej 23.99%, duke u renditur mbi mesataren globale prej 12.47%.

- Kosova është krahasuar me vende të ndryshme si:
- Kamboxhia (vendi i 33-të) me një përqindje prej 24.36%
- Kili (vendi i 34-të) me 24.17%
- Kanadaja (vendi i 36-të) me 23.84%
- Rumania (vendi i 37-të) me 23.58%

Kjo tregon se Kosova ka një performancë relativisht të mirë në nivel global për përdorimin e burimeve të rinovueshme moderne, duke lënë pas disa vende të zhvilluara si Kanadaja. Megjithatë, ende ka potencial për përmirësim për të arritur dhe tejkaluar performancën e vendeve si Kamboxhia apo Kili. Ky rezultat është pasqyrim i përpjekjeve për të promovuar përdorimin e burimeve si energjia diellore dhe ajo e erës, edhe pse infrastruktura dhe politikat për zhvillimin e qëndrueshëm ende mbeten sfida për vendin.

Renditja globale thekson nevojën për investime të mëtejshme dhe politika mbështetëse për të rritur më tej këtë përqindje dhe për të kontribuar në objektivat ndërkombëtare të klimës dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Prodhimi i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme

Burimet e rinovueshme si panelet diellore, turbinat e erës dhe digat hidroelektrike gjenerojnë energji elektrike pa djegur lëndë djegëse që lëshojnë gazra serrë dhe ndotës të tjerë. Me rënien dramatike të kostove të paneleve diellore dhe turbinave të erës gjatë viteve të fundit, burimet e rinovueshme tani përfaqësojnë burimin më të lirë për prodhimin e energjisë së re në shumë pjesë të botës.

Pjesa e burimeve të rinovueshme në prodhimin e energjisë elektrike, renditja globale 2022

Renditja	Shteti/Rajoni	%
-	Bota	29.4
115	Moldovi	9.6
116	Uzbekistan	9.3
117	Kosova	9.1
118	Afrika Jugore	8.4
119	Izrael	8.4

Burimi: Energy Transitions Indicators

Në renditjen globale për pjesën e energjisë së rinovueshme në prodhimin e energjisë elektrike për vitin 2022, Kosova zë vendin e 117-të me një përqindje prej 9.1%. Kjo shifër tregon një përdorim të kufizuar të burimeve të rinovueshme krahasuar me shumë vende të tjera, ndërkohë që mesatarja globale është 29.4%.

Krahasuar me shtetet e tjera, Moldavia (9.6%) dhe Uzbekistani (9.3%) qëndrojnë pak përpara Kosovës, ndërsa Afrika e Jugut dhe Izraeli janë të renditur menjëherë pas saj me 8.4%.

Kjo tregon se Kosova ka ende hapësirë të madhe për përmirësim, sidomos në kontekstin e tranzicionit global drejt energjisë së pastër dhe objektivave për uljen e gazrave serrë.

Një nga burimet më të mëdha të energjisë së rinovueshme jo-djegëse në Kosovë për vitin 2022 është era, që ka filluar të luajë një rol më të rëndësishëm në prodhimin e energjisë. Kjo tregon potencial për investime të mëtejshme në kapacitete të tilla, të cilat mund të ndihmojnë në diversifikimin e sektorit energjetik të vendit dhe përmbushjen e objektivave ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm. [5]

[5] Share of renewables in energy consumption, renewable electricity generation, link: <https://www.iea.org/countries/kosovo/renewables>

REZULTATET E HULUMTIMIT

Ky hulumtim është i rëndësishëm për të kuptuar qëndrimet dhe sjelljet e qytetarëve ndaj energjisë së rinovueshme, efikasitetit energjetik dhe subvencioneve në këtë fushë. Ai ofron një pamje më të qartë mbi shkallën e ndërgjegjësimit për përfitimet mjedisore dhe ekonomike të energjisë së pastër, si dhe sfidat që pengojnë adoptimin e saj.

Duke marrë në shqyrtim pikëpamjet e qytetarëve të Prizrenit, hulumtimi ndihmon për të kuptuar më mirë perceptimet dhe veprimet brenda një komuniteti specifik në Kosovë. Rezultatet e mëposhtme japin një përshkrim të hollësishëm mbi këto aspekte, duke ndihmuar në kuptimin më të thellë të situatës aktuale dhe mundësive për zhvillim të qëndrueshëm.



Energjia elektrike (64%) dhe druri (55%) janë burimet më të përdorura, duke treguar një varësi të lartë nga energjia tradicionale. Panelet diellore përdoren vetëm nga 3% e të anketuarve, çka tregon se energjia e rinovueshme nuk është ende e integruar gjerësisht në ngrohjen shtëpiake.



88% e të anketuarve e konsiderojnë kursimin e energjisë si shumë ose mjaft të rëndësishëm, çka tregon ndërgjegjësim të lartë mbi këtë çështje. Asnjë nga të anketuarit nuk e sheh kursimin e energjisë si pak ose aspak të rëndësishëm, një tregues pozitiv për fushatat e ndërgjegjësimit të deritanishme. Megjithatë, është e mundur që ky nivel i lartë ndërgjegjësimi të lidhet jo vetëm me njohuritë për përfitimet mjedisore, por edhe me faktorë ekonomikë, si rritja e çmimeve të energjisë dhe kostoja e jetesës. Kjo mund të sugjerojë se qytetarët e perceptojnë kursimin e energjisë si një masë të domosdoshme për të përballuar shpenzimet e larta të energjisë, të cilat ndodhin për shkak të tarifave të energjisë elektrike dhe konsumit të saj të lartë.



Vetëm 12% e të anketuarve janë shumë të informuar, ndërsa 31% janë mesatarisht të informuar mbi energjinë e rinovueshme. Një përqindje e konsiderueshme (28%) janë pak ose aspak të informuar, duke treguar një mungesë të qartë të edukimit dhe informimit mbi energjinë e rinovueshme.



Rrjetet sociale (34%), mediat tradicionale (29%) dhe shkolla/universiteti (29%) janë burimet kryesore të informacionit. Vetëm 5% kanë mësuar për energjinë e rinovueshme nga fushatat ndërgjegjësuese dhe vetëm 3% nga trajnimet dhe konferencat, duke treguar një nevojë për rritjen e aktiviteteve promovuese në këtë fushë.



90% e të anketuarve e shohin energjinë e rinovueshme si shumë ose mjaft të rëndësishme për mjedisin, duke treguar një nivel të lartë ndërgjegjësimi për ndikimin pozitiv të saj. Vetëm 2% e konsiderojnë aspak të rëndësishme, çka tregon një mbështetje të gjerë publike për energjinë e pastër.



60% e të anketuarve kanë bërë tashmë përmirësime për efikasitetin energjetik, ndërsa 31% po e konsiderojnë këtë hap. Vetëm 9% nuk i kanë bërë ose nuk i shohin të nevojshme përmirësimet energjetike, kryesisht për arsye të kostos së lartë.



61% janë të informuar për subvencionet, ndërsa 30% kanë dëgjuar për to, por nuk kanë informacione të detajuara. 9% nuk kanë dëgjuar fare për këto subvencione, çka sugjeron nevojën për promovim më të madh të tyre.



Nga ata që janë të informuar, vetëm 24% kanë aplikuar për subvencione, ndërsa 61% janë të interesuar por ende nuk kanë ndërmarrë hapa për të aplikuar. Shumica e atyre që nuk kanë aplikuar e justifikojnë këtë me mungesën e informacionit (38%) dhe procedurat e ndërlikuara të aplikimit (30%).



74% e të anketuarve besojnë se Kosova ka një potencial të madh për energjinë e rinovueshme, ndërsa 23% mendojnë se ky potencial është i kufizuar. Vetëm 3% besojnë se Kosova nuk ka fare potencial për këtë lloj energjie.



Mbështetja për kalimin e shkollave dhe institucioneve publike në energji të rinovueshme është jashtëzakonisht e lartë (91%), ndërsa vetëm 9% nuk kanë një mendim të qartë mbi këtë çështje. Asnjë nga të anketuarit nuk është kundër këtij ndryshimi, duke treguar një përputhje të madhe mes opinionit publik dhe politikave të mundshme për energjinë e gjelbër.



Ulja e ndotjes së ajrit (82%) dhe reduktimi i shpenzimeve energjetike (69%) janë përfitimet më të rëndësishme për të anketuarit. Pavarësia energjetike (35%) dhe krijimi i vendeve të punës (21%) vlerësohen më pak, ndoshta për shkak të mungesës së informacionit mbi ndikimin ekonomik të energjisë së rinovueshme.



70% janë të interesuar për trajnime apo fushata informuese në të ardhmen, duke treguar një potencial të madh për edukimin e mëtejshëm mbi energjinë e rinovueshme.

1 Cili është burimi kryesor i energjisë për ngrohje në shtëpinë tuaj?



Druri



54.6%



Energjia
elektrike



63.9%



Panelet
diellore



2.5%






Tjetër
(pelet)



2.4%



2 Sa është e rëndësishme kursimi i energjisë në jetën tuaj të përditshme?





13 CLIMATE ACTION






7 AFFORDABLE AND CLEAN ENERGY



3 Sa të informuar jeni për burimet e energjisë së rinovueshme (p.sh., panelet diellore, turbinat e erës, biomasa)?



4 Ku keni marrë informacionin tuaj kryesor për energjinë e rinovueshme?






13 CLIMATE ACTION



7 AFFORDABLE AND CLEAN ENERGY



5 Sa e rëndësishme mendoni se është përdorimi i energjisë së rinovueshme për të ardhmen e mjedisit?



13 CLIMATE ACTION



7 AFFORDABLE AND CLEAN ENERGY



6 A keni bërë përmirësime në shtëpinë tuaj për të rritur efikasitetin energjetik (p.sh., izolim, dritare të reja, sistem të ri ngrohje)?



Po




Jo, por e konsideroj



Jo, nuk kam nevoj për përmirësime



Tjetër (mundësitë financiare)



7 A jeni në dijeni të subvencioneve që ofron qeveria për përmirësimin e efikasitetit energjetik të shtëpisë suaj?

 Po, jam i/e informuar  61.3%

 Kam dëgjuar për to, por nuk jam i/e informuar  30.3%

 Jo, nuk di asgjë për këto subvencione  8.4%



7.1 Nëse po, a keni aplikuar për ndonjë nga subvencionet e ofruara?



Po



24.4%



Jo, por jam i interesuar



60.5%



Jo, nuk jam i interesuar



15.1%





7.2 Nëse nuk keni aplikuar për subvencione, cili është motivi kryesor?

 Mungesa e informacionit të mjaftueshëm  38.6%

 Procedura të ndërlikuara aplikimi  30.3%

 Nuk kam nevojë për përmirësime energjetike  6.6%

 Nuk i plotësoj kushtet/kriteret  20.9%



9 A do të dëshironit që shkollat dhe ndërtesat publike të kalonin më shumë në energji të rinovueshme?



Po



90.8%



Jo



9.2%

10 Cilat janë përparësitë kryesore që mendoni se ofron energjia e rinovueshme për Kosovën?

Ulje të ndotjes së ajrit

82.4%

Reduktim i shpenzimeve energjetike

68.9%

Krijim të vendeve të reja të punës

21%

Pavarësi energjetike

34.5%



13 CLIMATE ACTION



7 AFFORDABLE AND CLEAN ENERGY



11 A jeni në dijeni të subvencioneve që ofron qeveria për përmirësimin e efikasitetit energjetik të shtëpisë suaj?



Po



69.7%



Jo



30.3%



13 CLIMATE ACTION



7 AFFORDABLE AND CLEAN ENERGY



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Shumica e të anketuarve janë të informuar mesatarisht ose pak për burimet e rinovueshme të energjisë. Kjo tregon se ekziston një hendek i dukshëm mes grupeve të informuara dhe atyre që kanë nevojë për më shumë informacion. Mungesa e njohurive mund të ndikojë në aftësinë e qytetarëve për të marrë vendime të informuara mbi përdorimin dhe përfitimet e këtyre burimeve.

Pavarësisht nivelit të informacionit, të anketuarit shfaqin një qëndrim të fortë pozitiv ndaj kursimit të energjisë dhe mbështesin përdorimin e energjisë së rinovueshme. Ata theksojnë rëndësinë e saj për mjedisin dhe ndikimin pozitiv që mund të ketë në reduktimin e ndotjes dhe mbrojtjen e resurseve natyrore.

Megjithëse ekziston një mbështetje e madhe për energjinë e rinovueshme, përdorimi i saj mbetet minimal. Ky fenomen lidhet kryesisht me mungesën e infrastrukturës dhe informimit të duhur. Shumë qytetarë nuk kanë qasje të lehtë në teknologjitë e nevojshme dhe nuk janë të vetëdijshëm për mënyrat e aplikimit të tyre në jetën e përditshme.

Një tjetër sfidë e rëndësishme është mungesa e informacionit të detajuar mbi mbështetjen financiare për energjinë e rinovueshme.

Sipas anketës, 61% e të anketuarve janë të informuar për subvencionet e qeverisë për efikasitetin energjetik, por shumica prej tyre ende nuk kanë aplikuar. Kryesisht, kjo ndodh për shkak të mungesës së informacionit të mjaftueshëm dhe procedurave të komplikuar të aplikimit.

Kosova ka një potencial të madh për zhvillimin e energjisë së rinovueshme, por për ta shfrytëzuar plotësisht këtë mundësi, është e nevojshme një strategji më e qartë dhe implementim i duhur i politikave përkatëse. Krijimi i kushteve të favorshme për investime, si dhe edukimi i qytetarëve mbi përfitimet e energjisë së rinovueshme, mund të ndihmojnë në përsheptimin e këtij zhvillimi.

Bazuar në këto gjetje mund të rekomandojmë që akterët përgjegjës duhet të angazhohen më shumë në lidhje me këto çështje:

Thjeshtimin e procedurave të aplikimit për subvencione:

- Të krijohet një proces më i thjeshtë dhe më transparent për aplikimin për subvencione.
- Procedurat duhet të jenë të qarta dhe të qasshme për të gjithë qytetarët, duke siguruar mbështetje të mjaftueshme për ata që aplikojnë.

Përmirësimin e transparencës dhe shpërndarjes së subvencioneve

- Të krijohet një mekanizëm monitorimi që siguron që subvencionet të shpërndahen në mënyrë të drejtë, duke përfshirë më shumë familje me të ardhura të ulëta.
- Qeveria duhet të publikojë raportime të rregullta mbi shpërndarjen e subvencioneve dhe rezultatet e arritura nga këto skema.
- Të zhvillohen kanale të qarta komunikimi për të informuar qytetarët mbi mundësitë e tyre për subvencione.

Angazhimin e institucioneve publike për të kaluar në energji të rinovueshme

- Institucionet publike, si shkollat, spitalet dhe ndërtesat administrative, duhet të përfshihen në projekte pilot për kalimin në energji të rinovueshme.
- Qeveria të vendosë objektiva të qarta për uljen e konsumit të energjisë fosile dhe të sigurojë që institucionet publike të shërbejnë si shembuj pozitivë për sektorin privat.
- Partneritetet me organizata ndërkombëtare dhe donatorë mund të ndihmojnë në financimin e kësaj tranzicioni.

Përmirësimin e infrastrukturës për energjinë e rinovueshme

- Investimet duhet të fokusohen në ndërtimin e kapaciteteve për energji diellore, të erës dhe biomasa në shkallë më të gjerë.
- Modernizimi i rrjetit elektrik për të përballuar një pjesëmarrje më të madhe të burimeve të rinovueshme.
- Krijimi i infrastrukturës për vetëprodhuesit e energjisë, duke u mundësuar qytetarëve dhe bizneseve të prodhojnë dhe të shesin energji të tepërt në rrjet.

Zhvillimin e platformave digjitale dhe burimeve online për informacion

- Të krijohet një portal qendror ku qytetarët mund të informohen mbi subvencionet, politikat e qeverisë, hapat e aplikimit dhe përfitimet e energjisë së rinovueshme.
- Platforma duhet të përfshijë një seksion me pyetje dhe përgjigje të zakonshme, një kalkulator për përfitimet e kursimit të energjisë dhe një sistem për mbështetje teknike.
- Të zhvillohen aplikacione mobile për edukimin dhe ndërgjegjësimin mbi energjinë e rinovueshme.

Angazhimi e sektorit privat për të investuar në energjinë e rinovueshme

- Bashkëpunimi mes qeverisë dhe sektorit privat për zhvillimin e projekteve të përbashkëta në fushën e energjisë së rinovueshme.
- Ofrimi i lehtësirave për kompanitë që zbatojnë masa të efikasitetit energjetik në operacionet e tyre.

PËR EC:

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: **1.** Vëllimin e pamjaftueshëm të dijës empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, **2.** Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe **3.** Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për pale të treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente:

- 1. Gjithëpërfshirjen,**
- 2. Qëndrueshmërinë, dhe**
- 3. Dijen.**

EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithmbarshëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. **Paanshmëria** - EC vepron në bazë të analizave të thukëta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
2. **Aktivizmi** - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkë veprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. **Orientimi drejt rezultateve** - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
4. **Komuniteti bazë e veprimit** - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.

www.ecmandryshe.org